

V E N D I M
Nr. 50, datë 30.7.1999

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga :

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““

Me sekretare Arbenka Lalica, më datë 15.7.1999, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.51 Akti që i përket :

KËRKUESE: GJYKATA E RRETHIT SHKODER (KOLEGJI USHTARAK), i përfaqësuar nga ZZ. Hasan Selimi, Fuat Vjerdha e Besnik Hoxha.

SUBJEKT I INTERESUAR: KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, në mungesë.

O B J E K T I :

Papajtueshmëria e nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, me nenin 148 të Kushtetutës.

Si shkak për antikushtetutshmërinë e nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, parashtrohet se ky nen i jep të drejtë gjykatës të ndryshojë akuzën kur sipas nenit 148 të Kushtetutës një kompetencë e tillë i njihet vetëm prokurorit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi shpjegimet e kërkesit dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkesa e Gjykatës së Rrethit Shkodër (kolegjit ushtarak), është e pabazuar.

Në kundërshtim nga sa parashtrohet në kërkesë, e drejta që i njihet gjykatës për t'i dhënë faktit një përcaktim juridik të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori, nuk është veprim antikushtetues. Në këtë rast, gjykata nuk merr kompetencat e prokurorit dhe as kthehet në organ akuze, por vetëm zbaton ligjin, gjë që është detyrë funksionale e saj.

Kuptimi në këtë mënyrë i përmbajtjes së nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale i shërben dhënies së drejtësisë sepse në të kundërtën ajo do të vepronte në kundërshtim me provat dhe me ligjin. Në rast se gjykata nuk do të bënte një cilësim të drejtë të veprës penale, vendimi i saj do të prishej nga gjykata më e lartë për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Pra, edhe në këtë aspekt, gjykata është e detyruar të bëjë vetë ndryshimin e cilësimit të veprës kur ky është i ndryshëm nga ai i prokurorit.

Një interpretim i tillë i nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale që i jep këtë të drejtë gjykatës, del më mirë në dukje po të krahasohet me përmbajtjen e nenit 372 të këtij kodi. Në këtë dispozitë parashikohet e drejta e prokurorit për ndryshimin e akuzës dhe procedimin me akuzën përkatëse kur fakti del ndryshe nga ç'është përshkruar në kërkesën për gjykim. Kurse neni 375, parashikon ndryshimin e cilësimit juridik të veprës dhe të drejtën e gjykatës t'i japë faktit një përcaktim juridik të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori. Ky formulim i ndryshëm i këtyre neneve ka rëndësi të veçantë. Ai tregon se gjykata nuk është organ akuze, nuk formulon akuzë të re dhe as e ndryshon atë, por mbi bazën e faktit të paraqitur, bën cilësimin e duhur ligjor të veprës, duke i dhënë faktit një përcaktim tjetër. Në këtë rast, gjykata bën një interpretim të ligjit që ajo zbaton dhe që është në kompetencë të saj dhe nuk cënon aspak kompetencat e prokurorit.

Gjykata, duke i dhënë faktit një përcaktim juridik të ndryshëm nga ai i prokurorit, mund të bëjë që cilësimi i ri të jetë një vepër penale më e lehtë ose më e rëndë. Në rastin e fundit nuk do të thotë se rëndohet pozita e të pandehurit. Rëndimi i pozitës trajtohet në raport me shkallën më të lartë të gjykimit. Kur gjykata bën cilësimin e drejtë ligjor të veprës, pavarësisht nga karakteri i saj më i rëndë,

ajo ka bërë një zbatim të drejtë të ligjit dhe duke vënë në dijeni palët u krijon atyre mundësinë për t'u ankuar ndaj vendimit.

Për zbatimin e nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, kërkohen edhe kushte të tjera. Njëri nga kushtet është që gjykata këtë ndryshim mund ta bëjë kur vepra penale është në kompetencën e saj. Në rast se vepra penale nuk është në kompetencë të gjykatës, ajo nuk mund ta bëjë ndryshimin por ia dërgon çështjen organit kompetent. Kushti tjetër është që për ndryshimin të verë në dijeni palët. Kur gjykata bën ndryshimin gjatë seancës me vendim të ndërmjetëm, ua komunikon atë palëve. Por në rast se gjykata konstaton se duhet bërë ndryshimi i cilësimit juridik të veprës pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor kur është tërhequr për vendim, atëhere duhet të riçelë seancën dhe të vejë në dijeni palët, dhe të dëgjojë edhe pretendimet e tyre. Kështu ajo garanton të drejtën e mbrojtjes dhe të akuzës së prokurorit. Zbatimi në këtë mënyrë i kërkesave të nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, është një garanci për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, duke e vënë gjykatën në rolin që i takon për dhënien e drejtësisë.

Prandaj, neni 375 i Kodit të Procedurës Penale jo vetëm që nuk vjen në kundërshtim me nenin 148 të Kushtetutës, por është në përputhje edhe me parimet e tjera kushtetuese të zhvillimit të një gjykimi të drejtë nga një gjykatë e paanshme.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/a, 134/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 41 të Ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Formulimi i nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale i krijon mundësi gjykatës që të ndryshojë cilësimin e veprës penale si gjatë hetimit gjyqësor ashtu dhe në përfundim të tij.

Duke i lënë shteg ndryshimit të cilësimit juridik gjatë hetimit gjyqësor, kam mendimin se dispozita e mësipërme bie ndesh me dispozitat kushtetuese si dhe me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Në radhë të parë është e nevojshme të sqarohet se ashtu si vepra edhe cilësimi i saj juridik janë elementë thelbësorë të akuzës në kuptimin se s'mund të pranohet, mohohet apo ndryshohet cilësimi juridik, pa arritur në përfundim se fakti ekziston, është i vërtetë.

Në këto kushte, a mundet gjykata që gjatë hetimit gjyqësor, pa arritur në konkluzionet përfundimtare mbi ekzistencën e faktit të prononcohet në cilësimin e tij juridik. Kjo është e pamundur, ndryshe do t'i jepej padrejtësisht gjykatës roli “akuzator”

Është e vërtetë që në bazë të sistemit tonë procedural penal, gjykata ka rol aktiv, por jo deri në atë masë sa ky rol të çënojë paanësinë e saj. Të pranosh ose ndryshosh cilësimin e një fakti, i cili deri në këtë fazë të procesit prezumohet, është hipotetik, do të thotë të paragjykos çështjen kur ende ajo s'ka përfunduar.

Ndryshe qëndron problemi në përfundim të hetimit gjyqësor, kur nga bisedimet arrihet në radhë të parë në konkluzione mbi ekzistencën e faktit e më pas në cilësimin juridik të këtij fakti. Një zgjidhje të tillë i jep me të drejtë problemit edhe neni 521 i Kodit të Procedurës Italiane, i cili pranon ndryshimin e cilësimit juridik të veprës nga gjykata në vendimin përfundimtar.

Për këto arsye kam mendimin se kërkesa duhej pranuar përsa i përket shprehjes “duke njoftuar palët...”.

ANËTARI
A. Karamuço

Tiranë, më 30.7.1999

Nr. 51 i regjistrit themeltar
Nr. 50 i vendimit.